Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 1285
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 15/01 2025
KAMENICË/A

**Zyra e Kryetarit** **Sh.02.Nr.03 datë:15.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022 nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.2023/të datës: 21.06.2023 të Komunës së Kamenicë, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**
**LOT 2 Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kamenicë**

1. Caktohet ekipa menaxhuese e kontratës dhe mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ekipës menaxhuesekontratës me titull: **"LOT 2 Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kamenicë** me numër të kontratës **KM 653-24-10226-5-1-1/C671,** si në vijim:

   **1.1 Vlonë Matoshi** (DIK)
   **1.2 Besart Fejzullahu** (DUPH)
   **1.3 Imran Morina** (DIK) dhe
   **1.4 *Sylejman Kallaba*** (DUPH) CAKTOHET mbikëqyrës i drejtpërdrejtë e ekipes menaxhuse.

2. Ekipa Menaxhuese e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ekipës menaxhuese të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Të dërgoj raporte të rregullta javore, për procesin e përmbushjes së kontratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***T'i dërgohet:***
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- Ekipës Menaxhuese dhe Mbikqyrësit;
- Arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES · KOMUNA E KAMENICES · 02 KRYETARI · REPUBLIKA KOSOVA · OPSTINA KAMENICA · PREDSEDNIK OPSTINE

# KONTRATË

Numri i kontratës:[1]: **KM653-24-10226-5-1-1/C671**

**KOMUNA E KAMENICËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**Grup i Operatorëve Ekonomik „VARNA SH.P.K.; LIMITPROJECT SH.P.K., katundi i ri, Kamenica**, (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

**LOT-1-Ndërtimi i Çerdhës në Roganë-Kamenicë LOT-2-Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kamenicë** me numër identifikues: **KM653-24-10226-5-1-1**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **LOT-1-Ndërtimi i Çerdhës në Roganë-Kamenicë LOT-2-Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kamenicë**

| No. | Lot |
|---|---|
| 2 | **LOT-2-Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Kamenicë** |

**Neni 2 Çmimi**

**2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 783,248.58€ ShtatëqindetetëdhjetëetremijëedyqindedyzeteteEuroe58cent**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

EKIPA MONITRUESE
VLONË MATOSHI
BOSAR FEJZULLAHU
IMRAN MOKINA
MBS:
SYLEJMAN KALLABA

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit

---

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANI
Sh. Nr. 02 Br. 1497
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 20/01 2025
KAMENICË/A

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.09, datë:17.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Publike Kornizë AQP – 227 - 24 e datës 02.12.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e Menaxherit të Kontratës "LOT 6 – Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Niveli Qendror dhe Lokal"**

1. CAKTOHET Menaxheri i kontratës me titull: **"LOT 6 – Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Niveli Qendror dhe Lokal", Nr. Prokurimit: UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe** numëri i Kontratës: **UA/2016–24–8838–1–1-1/C627,** me këtë përbërje:

2. **z. Shefik Rudhani** (DKA), CAKTOHET Menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

3. Obligohet menaxheri i kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

4. Vendimit i bashëngjitet: Kontrata Publike Kornizë AQP – 227-24 e datës 02.12.2024 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit me numër të prokurimit UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe numër të Kontratës UA/2016-24-8838-1-1-1/C627.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***T'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Shefik Rudhani (DKA); dhe
- QSHQ-arkivt.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. / Br. 02 / 1503
Nr. i faq. / Br. str. 1
Data: / Datum: 20/01/2025
KAMENICË/A

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.08, datë:17.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Publike Kornizë AQP – 245 - 24 e datës 05.12.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e Menaxheres së Kontratës "LOT 1 – Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit"**

1. CAKTOHET Menaxhere e kontratës me titull: **"LOT 1 – Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit", Nr. Prokurimit: UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe** numëri i Kontratës: **UA/2016–24–8838–1-1-1/C623,** me këtë përbërje:

2. **znj. Artina Demolli** (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit), CAKTOHET Menaxhere e kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

3. Obligohet menaxherja e kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

4. Vendimit i bashëngjitet: Kontrata Publike Kornizë AQP – 245-24 e datës 05.12.2024 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit me numër të prokurimit UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe numër të Kontratës UA/2016-24-8838-1-1-1/C623.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***T'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Artina Demolli (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit); dhe
- QSHQ-arkivt.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
02 Nr./Br. 1504
Nr. i faq./Br. str. 1 Data:/Datum: 20/01
KAMENICË/A 2025

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.07, datë:17.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Publike Kornizë AQP – 244 - 24 e datës 05.12.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e Menaxheres së Kontratës "LOT 2 – Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës"**

1. CAKTOHET Menaxhere e kontratës me titull: **"LOT 2 – Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës", Nr. Prokurimit: UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe** numëri i Kontratës: **UA/2016–24–8838–1–1-1/C624,** me këtë përbërje:

2. **znj. Artina Demolli** (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit), CAKTOHET Menaxhere e kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

3. Obligohet menaxherja e kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

4. Vendimit i bashëngjitet: Kontrata Publike Kornizë AQP – 244-24 e datës 05.12.2024 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit me numër të prokurimit UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe numër të Kontratës UA/2016-24-8838-1-1-1/C624.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***T'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Artina Demolli (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit); dhe
- QSHQ-arkivt.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: AQP
Nr. Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 244/24
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 1/28
Data / Datum / Date: 05.12.2024
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government**
***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers***
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

# KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

## TITULLI I KONTRATËS:

## FURNIZIM ME ARTIKUJ USHQIMOR

## LOT 2 - FURNIZIM ME MISH PULE DHE PRODUKTE TË MISHIT TË PULËS

## NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-24-8838-1-1-1

## NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-24-8838-1-1-1/C624

Caktohet menaxhere kontrate
ARTINA DEMAJ

~~DMSHS~~ DSHMS

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

**PJESA I E KONTRATËS:** KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

" **Beni Dona Plast SH.P.K., Ulpiana Tregu i Gjelbërt, 10000, PRISHTINË, Kosovë; Email:** prokurimi.zyra@gmail.com; **(ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizim me:**

**Furnizim me artikuj ushqimor – LOT 2 - Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës**

me numër identifikues: **UA/2016-24-8838-1-1-1/C624**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

**Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës**

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7.

Gjatë implementimit të kontratës mund të shtohen autoritete tjera nëse do të formohen gjatë kësaj kohe apo nëse ju lind nevoja për këto produkte apo nëse kanë arsyetim tjera objektiv për mungesën e tyre në Aneksin 7, në këto raste AQP do ju mundësoj shfrytëzimin e kontratës pas kërkesës së tyre dhe vlerësimit nga AQP-ja.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoritetet Kontraktues të përmendur në Nenin 1.1 janë të detyruar të përdorin këtë kontratë kornizë sa herë që të blejnë mallëra të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15.12.2024 dhe përfundon në datën 14.12.2025.

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë jo më shumë se **3 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Vendi i përcaktuar nga Autoritetet kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë..

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

**Neni 3 Origjina**

---

[17] DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Nr. 02 Br. 1506
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 20.01
KAMENICË/A 2025

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.06, datë:17.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Publike Kornizë AQP – 229 -24 e datës 04.12.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e Menaxheres së Kontratës "LOT 4 – Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor"**

1. CAKTOHET Menaxhere e kontratës me titull: **"LOT 4 – Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor", Nr. Prokurimit: UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe** numëri i Kontratës: **UA/2016–24–8838–1–1-1/C626,** me këtë përbërje:

2. **znj. Besarta Ahmeti** (DKA), CAKTOHET Menaxhere e kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

3. Obligohet menaxherja e kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

4. Vendimit i bashëngjitet: Kontrata Publike Kornizë AQP – 229-24 e datës 04.12.2024 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit me numër të prokurimit UA/2016-24-8838-1-1-1 dhe numër të Kontratës UA/2016-24-8838-1-1-1/C626.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***T'i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Besarta Ahmeti (DKA); dhe
- QSHQ-arkivt.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 1632
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 21/01 2025
KAMENICË/A

Nr./25

Datë:21/01/2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit nr 03/l-40 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Konursit Nr 02/626 të dates 09.01.2025 te shpallur per poziten : Asistent/e Administrativ, Udhëheqësi më i Lartë Administrativ nxjerr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË PRANIMIT

1. Formohet Komisioni i Pranimit për pozitën e punës: Asistent/e Administrativ me këtë përbërje:

1.1 Valdete Berisha Murina, Kryesues;
1.2 Riad Rahimaj, anëtar;
1.3 Liridon Rexhepaj, anëtar;

2. Komisioni i formuar sipas pikës (l) një të këtij vendimi do t'i zhvilloj procedurat e rekrutimit për të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në pozitën e lartëcekur, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit dhe dispozitave ligjore ne fuqi.

3. Komisioni pas përfundimit të procedurave të intervistimit të kandidatëve e rekomandon kandidatin fitues i cili ka treguar rezultate me te mira gjatë intervistimit.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit:
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivës.

Kadri RAHIMAJ

Kryetar i Komunës së Kamenicës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TË GY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 1697 Br.
Nr. i faq. 1 Br. str. Data: 21.01 Datum: KAMENICË/A 2025

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.nr.10 datë:20.01.2025**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7 të Rregullores Sh.01.31251 i dates 29.09.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, Neni 8 i Rregullorës MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Thirrjes Publike Sh.02.Nr.37364 e datës 04.12.2024 për Mbështetje Financiare për Organizimin e Konferencës Shkencore "Kamenica në Rrjedha të Historisë", si dhe neni 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari Komunës merr këtë:

# VENDIM

## Për Formimin e Komisionit Vlerësues për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Mbështetjen Financiare në Organizimin e Konferencës Shkencore "Kamenica Në Rrjedha të Historisë"

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për mbështetje financiare në organizimin e konferencës shkencore "Kamenica në rrjedha të historisë", në këtë përbërje:

   1.1. Venera Dërmaku (DKRS), Kryesuese;
   1.2. Liridon Rexhepaj (ZK), anëtar;
   1.3. Vlera Bugaqki (QPS), anëtare;
   1.4. Lavdim Klaiqi (Shoqëria Civile), anëtar;
   1.5. Labinot Dërmaku (DFB), anëtar; dhe
   1.6. Ajshe Hoda Thaqi (DKRS), anëtare reservë.

2. Detyrë e komisionit të lartëcekur, është të shqyrtojë aplikacionet për mbështetje financiare në organizimin e konferencës shkencore "Kamenica në rrjedha të historisë", sipas kritereve të përcaktuara në bazë të Thirrjes Publike Sh.02.Nr.37364 e datës 04.12.2024 për Mbështetje Financiare në organizimin e konferencës shkencore "Kamenica në rrjedha të historisë".

3. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioni i Raporton Kryetarit të Komunës.

4. Vendimit i bashkangjitet Thirrja Publike Sh.02.Nr.37364 e datës 04.12.2024 për mbështetje financiare në organizimin e konferencës shkencore "Kamenica në rrjedha të historisë".

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dorëzohet:*** Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Anëtarëve të Komisionit dhe QSHQ – arkivit.

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E KAMENICËS – KRYETARI I KOMUNËS – REPUBLIKA KOSOVA – OPŠTINA KAMENICA – PREDSEDNIK OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 1699 Br.
Nr. i faq. 2 Data: 21/01/2025 Datum:
Br. str.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit** **Sh.02 Nr.02, datë: 13.01.2025**

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, Vendimi Bazë Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-24-2222-2-1-1, Kryetari i Komunës merr këtë :

## VENDIM

**Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-24-2222-2-1-1**

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një) nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Bazë Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-24-2222-2-1-1.

   **1.1.** Paragrafi **1** (një) nënparagrafi **1.1** (një pike një) i Vendimit Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-24-2222-2-1-1, ndryshohet dhe plotësohet: Në vend të Kryesuesit të Ekipës Menaxhuese **z. Mehmet Thaçi** (DUPH), caktohet Kryesuese e Ekipës Menaxhuese **znj. Vlonë Matoshi** **(Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale).**

   **1.2.** Obligohet z. Mehemet Thaçi – Kryesues i Ekipës Menaxhuese i caktuar sipas Vendimit Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-24-2222-2-1-1, që znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale) e caktuar Kryesuese e Ekipës Menaxhuese sipas këtij Vendimi, të i dorëzoj Raport me shkrim lidhur me prerjen e punëve të kryera deri në periudhen e ndryshimit dhe plotësimit të Vendimit Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Menaxhimin e Kontratës.

2. Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024.

3. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

4. Këtij Vendimi i bashkangjitet kopja e Vendimi Bazë Sh.02.Nr.18228 i datës 04.06.2024 për Formimin e Ekipës për Menaxhimin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Kontratës me titull: "Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale" me numër Identifikues të Prokurimit: KM653-

24-2222-2-1-1.

***Me vendim të njoftohet***: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, z. Mehmet Thaçi (DUPH), znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale) dhe arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 2068
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 27/01 2025
KAMENICË/A

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**KOMUNA E KAMENICËS**
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

---

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.12, datë: 27.01.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi Sh.02.Nr.1462 i datës 22.01.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 283.60 €**

1. Lejohet pagesa e faturës 0050404 të datës 28.12.2024, në shumën prej 283.60 € për shpenzimet e krijuara në Restaurant "KONAKU" sh.p.k në Berivojcë / Kamenicë, Me rastin e darkës të organizuar nga Komuna e Kamenicës dhe Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.

2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 16029 i Zyrës së Kryetarit, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për faturën Sh.02.Nr.1462 i datës 22.01.2025, Fatura 0050404 të datës 28.12.2024, dhe kuponi fiskal në shumën prej 283,60 €.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendim t`i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- DFB-së ; dhe
- Arkivit.

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 2113
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 28/01/2025
KAMENICË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

---

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.13, datë: 27.01.2025**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Arsyetimi i datës 20.01.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR LEJIMIN E PAGESËS NË VLERË PREJ 680.00 €

1. Lejohet pagesa e faturës 5067431 të datës 20.01.2025, në shumën prej 680.00 € për shpenzimet e krijuara në Casa Mia Eatery Bar SH.P.K në Kamenicë, Në organizimin e Flakës së Janarit, u mbajt edhe Ecja Tradicionale, ku morën pjesë rreth 200 persona nga 16 klube dhe shoqata bjeshkatare nga Kosova dhe më gjerë. Dreka për të gjithë pjesëmarrësit, në vlerë prej 680 euro, u organizua në Shtëpinë Muze "Kadri Zeka".

2. Pagesa të bëhet nga kodi buxhetor 85029 i DKRS-së, në xhirollogarinë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkangjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në Kamenicë në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Vendimit i bashkangjitet Arsyetimi për faturën i datës 20.01.2025, Fatura 5067431 të datës 20.01.2025, në shumën prej 680,00 €.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendim t`i dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informimin;
- DKRS-së;
- DFB-së; dhe
- Q.SH.Q – Arkivit.

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 2199
Br.
Nr. i faq. 1 Data 28/01
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02 Nr.17, datë: 28.01.2025**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, dispozitave të nenit 70 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale**

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale, në këtë përbërje:

   **1.1.** Valdete Berisha (ZK), Kryesuese;
   **1.2.** Vesna Kenic (ZK), anëtare;
   **1.3.** Durim Biqkaj (DSHMS), anëtar;
   **1.4.** Artan Reka (ZK), anëtar; dhe
   **1.5.** Hyrije Dërvodeli (DAP), anëtare.

2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Rregulloren Komunale për Transparence dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale, e cila ka për qëllim forcimin e transparencës në punët e organeve të Komunës siç janë Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës si dhe organet e tjera të Administratës.

3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna si dhe në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Grupit Punues për hartimin e Rregullores Komunale për Transparencë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Grupit Punues; dhe
- Q.SH.Q–Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS * OPŠTINA KAMENICA
02 KRYETARI I KOMUNËS
PREDSEDNIK OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 2204
Nr. faqes 2 Data Datum: 28/01
KAMENICË/A 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02 Nr.15, datë: 27.01.2025**

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, Vendimi Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës me titull "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

**Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës me titull "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1**

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një) nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës me titull "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1.

   **1.1.** Paragrafi **1** (një) nënparagrafi **1.1** (një pike një) i Vendimit Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës me titull "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1, ndryshohet dhe plotësohet: Në vend të Menaxheres së Kontratës **znj. Vjollcë Kryeziu** (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale), caktohet Menaxher i Kontratës **z. Sylejman Kallaba** (DUPH).

2. Obligohet znj. Vjollcë Kryeziu që, në cilësinë e Menaxheres së Kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.33983 të datës 24.10.2024, të dorëzojë një raport të detajuar me shkrim lidhur me punët e kryera deri në periudhën e ndryshimit të vendimit në kontratën "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1, dhe raportin t'ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, z. Sylejman Kallaba.

3. Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024.

4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

5. Këtij Vendimi i bashkangjitet kopja e Vendimi Bazë Sh.02.Nr.33983 i datës 24.10.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së

kontratës me titull "Renovimi i Sallës së Kuvendit tek Shtëpia e Kulturës dhe Renovimi i Sallës së Kuvendit – Tek Objekti i Komunës" me numër të kontratës KM653-24-9561-5-2-1.

***Me vendim të njoftohet***: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, znj. Vjollcë Kryeziu (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale), z. Sylejman Kallaba (DUPH), znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale) dhe Q.SH.Q - arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 02 Nr. 2210
Br.
Nr. Fleq. 1 Data 28/01
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2025

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.16, datë:28.01.2025**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, nenit 7 paragrafi 6 dhe neni 17 të Rregullores Sh.01.Nr.31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

**V E N D I M**

1. **FORMOHET** – Komisioni me mandat (2) dy vjeçar për shqyrtimin e kërkesave individuale për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik, me këtë përbërje:

   **1.1.** Qëndresa Kastrati (DZHED), Kryesuese;
   **1.2.** Edon Dërmaku (DZHED), anëtar;
   **1.3.** Liridon Rexhepaj (ZK), anëtar;
   **1.4.** Arben Hoxha (DFB), anëtar;
   **1.5.** Lavdim Klaiqi (Shoqëria Civile), anëtar; dhe
   **1.6.** Zijadin Thaqi (ZK), anëtar rezervë në komision në rast konflikti të interesit nga anëtarët e tjerë.

2. Komisioni nga pika (1) e këtij Vendimi është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve dhe kërkesave për ndarjen e subvencioneve në fushën e Zhvillimit Ekonomik. Ky komision ka detyrë të rekomandojë dhe të hartojë vendimin për aprovimin ose refuzimin e kërkesave, të cilin ia paraqet Kryetarit të Komunës, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregulloren Sh.01.Nr.31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ-arkiv

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAMENICËS
02 KRYETARI I KOMUNËS
PREDSEDNIK OPSTINE
REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA KAMENICA

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh./U. 02 Nr./Br. 2212
Nr. Faq./Br. str. 1 Data/Datum: 28/01/2025
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02 Nr.14, datë: 27.01.2025**

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58 shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, Vendimi Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës me titull "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

**Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës me titull "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6**

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2 (dy) i Vendimit Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës me titull "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6.

   **1.1.** Paragrafi 2 (dy) i Vendimit Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës me titull "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6, ndryshohet dhe plotësohet: Në vend të Menaxheres së Kontratës **znj. Vjollcë Kryeziu** (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale), caktohet Menaxher i Kontratës **z. Sylejman Kallaba** (DUPH).

2. Obligohet znj. Vjollcë Kryeziu që, në cilësinë e Menaxheres së Kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.38963 të datës 24.12.2024, të dorëzojë një raport të detajuar me shkrim lidhur me punët e kryera deri në periudhën e ndryshimit të vendimit në kontratën "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6, dhe raportin t'ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, z. Sylejman Kallaba.

3. Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024.

4. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

5. Këtij Vendimi i bashkangjitet kopja e Vendimi Bazë Sh.02.Nr.38963 i datës 24.12.2024 për Caktimin e Menaxheres së Kontratës me titull "Riparimi i fasadës dhe kulmit të dëmtuar gjatë punëve demoluese të objektit të ish kadastrit" me numër të kontratës KM653-24-12777-5-3-6.

***Me vendim të njoftohet***: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, znj. Vjollcë Kryeziu (Konsulente, Drejtoria për Investime Kapitale), z. Sylejman Kallaba (DUPH) dhe Q.SH.Q - arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY.
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 2331
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 30/01 2025
KAMENICË/A

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.18, datë 30.01.2025**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), neni 70 paragrafi 70.2 shkronja e) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë vendim:

# V E N D I M

1. znj. Burbuqe Leka, Drejtore e Drerjtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë (DZHED), i delegohen përgjegjësit për nënshkrimin e ''Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Shoqatës Renesansa për përkrahjen e luftës kundër kancerit të gjirit.

2. znj. Burbuqe Leka nuk mund t`i nëndelegojë këto kompetenca zyrtareve të tjerë.

3. Delegimi i përgjegjësive sipas pikës 1 të këtij vendimi do të zgjasë aq sa zgjatë mandati i Drejtores së Drerjtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë (DZHED).

4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet***:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- znj. Burbuqe Leka (DZHED); dhe
- QSHQ-Arkivi.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 2332
Nr. i faq. Br. str. 4 Data: Datum: 30/01 2025
KAMENICË/A

RENESANSA

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**KOMUNËS SË KAMENICËS**

**DHE**

**SHOQATËS "RENESANSA" PËR PËRKRAHJEN E LUFTËS KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT**

**Neni 1**
**Palët e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është lidhur ndërmjet:

1. Komunës së Kamenicës, me adresë Rr.Skenderbeu, e përfaqësuar nga Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Kamenicës, znj. Burbuqe Leka, (në tekstin e mëtejmë: "Komuna"), dhe

2. Shoqatës "Renesansa" për Përkrahjen e Luftës Kundër Kancerit të Gjirit, me adresë Rr. Kadri Gjata, Kati 2, Nr. 8, Prishtinë, e përfaqësuar nga Kryetarja znj. Violeta Pirana (në tekstin e mëtejmë: "Shoqata").

## Neni 2
## Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të mbështetet Shoqata "Renesansa" për të promovuar sensibilizimin, parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit për gratë dhe vajzat e Komunës së Kamenicës, duke siguruar mbështetje të arsyeshme financiare dhe logjistike.

## Neni 3
## Fushat e Bashkëpunimit

Palët angazhohen për:

**3.1.** Organizimin e fushatave të informimit dhe edukimit publik mbi kancerin e gjirit.

**3.2.** Sigurimin e hapësirave publike për aktivitetet sensibilizuese dhe trajnimet.

**3.3.** Mbështetjen logjistike dhe financiare të Shoqatës, bazuar në kapacitetet buxhetore të Komunës.

**3.4.** Organizimin e kontrolleve mjekësore falas në bashkëpunim me institucionet shëndetësore lokale.

## Neni 4
## Obligimet e Palëve

**4.1. Obligimet e Komunës:**

**4.1.1.** Të mbulojë shpenzimet e anëtarësimit për 35 gra dhe vajza të Komunës së Kamenicës në Shoqatë, ku kostoja e anëtarësimit është 30 euro për një të anëtarësuar, megjithatë ky numër mund të rritet pasi mund të përfshihen edhe më shumë anëtarsime në varësi të interesimit.

**4.1.2.** Të mbështesë financiarisht aktivitetet kryesore të Shoqatës, duke parë prioritetet vjetore.

**4.1.3.** Të sigurojë hapësira publike pa pagesë për aktivitetet sensibilizuese dhe edukative.

**4.1.4.** Mbështetje për transportin e pacientëve në pjesëmarrje të konferencave dhe për aktivitete kur eshtë e nevojshme.

4.1.5. Të promovojë aktivitetet e Shoqatës përmes kanaleve të komunikimit të Komunës.

**4.2. Obligimet e Shoqatës:**

4.2.1. Të organizojë aktivitete edukuese dhe informuese për parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit.

4.2.2. Të ofrojë shërbimet falas të përcaktuara në Nenin 3, brenda kapaciteteve ekzistuese të Shoqatës.

4.2.3. Të hartojë raporte periodike mbi aktivitetet e realizuara dhe të raportojë në Komunë.

4.2.4. Të bashkëpunojë me institucionet lokale shëndetësore për kontrollet mjekësore falas.

4.2.5. Mbështetje për transportin e pacientëve në pjesëmarrje të konferencave dhe për aktivitete kur eshtë e nevojshme.

4.2.6. Sigurimi i pajisjeve ndihmëse (p.sh., proteza, paruke dhe brusa pas mastektomisë), për pacientët në nevojë.

**Neni 5**
**Koordinimi mes Palëve**

5.1. Palët do të krijojnë një linjë të përhershme komunikimi për të siguruar zbatimin e marrëveshjes.

5.2. Do të organizohen takime të rregullta (të paktën dy herë në vit) për të vlerësuar progresin e aktiviteteve dhe për të adresuar sfidat.

**Neni 6**
**Konfidencialiteti**

Palët janë të obliguara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informatave të ndara gjatë bashkëpunimit.

**Neni 7**
**Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej 1 viti, me mundësi zgjatjeje pas rishikimit dhe miratimit nga të dyja palët.

## Neni 8
## Ndryshimi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

**8.1.** Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratim të ndërsjelltë me shkrim nga të dyja palët.

**8.2.** Cilado nga palët mund ta përfundojë marrëveshjen me njoftim të shkruar paraprak prej 30 ditësh.

## Neni 9
## Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me negociata të drejtpërdrejta. Në rast të dështimit të negociatave, mosmarrëveshjet do të dërgohen për zgjidhje në instancat kompetente ligjore.

## Neni 10
## Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hartohet në dy (2) kopje origjinale fizike, nga një (1) për secilën palë.

## Neni 11
## Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Palët nënshkruese**
**Kamenicë, datë 30 Janar 2025**

| | |
|---|---|
| **Shoqata Renesansa** | **Komuna e Kamenicës** |
| **znj. Violeta Pirana** | **znj. Burbuqe Leka** |